

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA "ADRIATIKA BETON" SH.P.K.**  
**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**Me seli në Shkozë, Ish-N.Sh.N, Shkozë, Durrës**  
**NIPT K32227505V**

---

**V E N D I M**

**MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**  
**TË SHOQËRISË "ADRIATIKA BETON" SH.P.K.**

Në Durrës, sot më datë 01 Nëntor 2013(dymijë e trembëdhjetë), në ambientet e selisë ligjore të shoqërisë, Ish-N.Sh.N, Shkozë, Durrës, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, "ADRIATIKA BETON" Shpk.

Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K, është regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendim Nr. 29773, datë 30.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIPT K32227505V dhe seli të saj në adresën: Ish-N.Sh.N, Shkozë, Durrës, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K ka një kapital në shumën 162'589'000/0(njëqind e gjashtëdhjetë e dymilion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 162'589 (njëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) kuota, secila me vlerë nominative 1'000(një mijë) Lekë dhe ortakë të shoqërisë, Z. Ardian Muka që zotëron 30%(tridhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë dhe "INER" Sh.p.k. që zotëron 70%(shtatëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë të cilët, të dy së bashku, përbëjnë 100%(njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.P.K.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k., është thirrur me kërkesën e të gjithë ortakëve të shoqërisë. Verifikohet pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë, nga ku rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm, si më poshtë:

1. **ORTAKU : Z. Ardian MUKA**, shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1967, në Durrës, Shqipëri, banues në adresën: Lagjja Nr. 6, Rruga "Bashkimi" Nr. 65, Durrës,
2. **ORTAKU : Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "INER"**, person juridik shqiptar, i regjistruar me Vendimin Nr.20546, datë 12.01.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pajisur me Çertifikatë Regjistrimi, me Numër Identifikimi (NIPT) J81917002H, me seli në adresën: rruga "Perlat Rexhepi" Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga **Z. Artan DULAKU, Z. Adrian DULAKU** dhe **Genci DULAKU**, të autorizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "INER" Sh.p.k.,

që do të thotë se janë të pranishëm 100%(njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k, gjë që do të thotë se asambleja është thirrur rregullisht, dhe në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tretare" përkatësisht nenit 81, 83 paragrafi 1, 86, e vijues të tij, dhe Statutit të shoqërisë, me praninë e ortakëve, të cilët janë dakord dhe në gjendje për të diskutuar dhe për të vendosur, çështje që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, për të diskutuar dhe shqyrtuar mbi;

## PIKAT E RENDIT TË DITËS SI MË POSHTË:

1. Shqyrtimin e Raportit të datës 28.10.2013, Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Shpk, të hartuar nga Studio e Auditimit "Filito Auditing" shpk, me numër NIPT K81401002H.
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Shpk.
3. Të tjera dhe eventuale.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k., pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe aktet përkatëse, në zbatim të nenit 81, paragrafi 1, pika "ë" dhe nenit 87, paragrafi 1, e vijues të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me votën pro, të 100% të totalit të kuotave të kapitalit të shoqërisë, pra me shumicën e kualifikuar të kërkuar nga ligji, në përfundim, në unanimitet të plotë

## VENDOSI:

1. Të miratojë "Raportin për zmadhim kapitali", të datës 28 Tetor 2013, të Studios së Auditimit "Filito Auditing" shpk, me numër NIPT K81401002H, me eksperte Kontabël të Autorizuar zj. Tatiana Filto(Kotepano) me Nr.Liçense 68, raport i cili ka evidentuar zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" Shpk.
2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk, nëpërmjet rezervave të krijuara nga fitimet e vitit ushtrimor 2012, për vlerën prej 1'938'000(një milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë)Lekë.
3. Si rrjedhim i këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë "ADRIATIKA BETON" shpk, bëhet në vlerën totale prej 164'527'000(Njëqind e gjashtëdhjetë e katër million e pesëqind e njëzet e shtatë mijë) Lekë, i ndarë në 164'527(njëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e pesëqind e njëzet e shtatë) kuota me vlerë nominale 1'000(njëmijë) Lekë për kuotë.
4. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
5. Sa më sipër, ky vendim do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për t'u pasqyruar kufizimet përkatëse në përputhje me nenin 12, 81, nenit 87, paragrafi 1, e vijues, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nenit 43 e vijues, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Asambleja e Përgjithshme**  
**Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.p.k.**  
**Ortakët e Shoqërisë**

**"INER" Sh.p.k.**  
Përfaqësuar nga :

Përfaqësuesit e autorizuar:

**Z. Artan DULAKU Z. Adrian DULAKU Z. Genci DULAKU**

**Ardian MUKA**

*Ardian Muka*

